



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Prishtinë 09/07/2019

Termet e referencës

Ekspert për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor

Qëllimi i angazhimit të ekspertit afatshkurtër të jashtëm

Zyra Kombëtare e Auditimit është në proces të auditimit të performancës “Siguria në Komunikacionin Rrugor”. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti të auditimit është vlerësimi i efektivitetit të aktiviteteve të Policisë së Komunikacionit Rrugor në bashkëpunim me nivelin qendror dhe lokal (Ministrinë e Infrastrukturës dhe Komunën e Prishtinës) për ofrimin e sigurisë në rrugë rajonale dhe lokale në vend.

Për shkak të fushës dhe njohurive specifike që kërkohen për kryerjen e këtij auditimi, Zyra Kombëtare e Auditimit kërkon angazhimin e ekspertit të sigurisë rrugore.

Kohëzgjatja e angazhimit është 8 ditë pune.

Përshkrimi i punës dhe detyrat kryesore të Ekspertit të Komunikacionit Rrugor

Eksperti i sigurisë rrugore duhet të përkrahë ekipin me udhëzimet dhe ekspertizën në interpretimin e legjislacionit në fuqi sa i përket kësaj fushe së bashku me rolin e secilit institucion në rritjen e sigurisë të lëvizjes në trafikun rrugor si dhe vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve të auditimit

Eksperti po ashtu duhet të ofroj ekspertizën rreth standardeve të aplikuara (nderkombëtare) për rruget dhe trafikun rrugor si dhe aspektin e praktikave të mira të cilat kanë ndikim në rritjen e sigurisë rrugore në vend duke rekomanduar përmirësime për mangësitë që identifikohen.

Ndër të tjera, përgjegjësi të ekspertit janë:

- Puna e ekspertit është e nevojshme gjatë fazës së rishikimit të të gjeturave të auditimit dhe hartimit të raportit duke u bazuar në standardet e aplikuara të sigurisë rrugore si dhe të ofroj praktikave të mira lidhur me sigurinë rrugore dhe krahasime me vendet tjera;
- Vlerësimi i rezultateve audituese lidhur me implementimin e masave konkrete që dalin nga Plani i Veprimtë Strategjisë kombëtare për sigurinë në trafikun rrugor;
- Të vlerësoj obligimet që kanë institucionet në marrjen e veprimeve direkte për të përmirësuar sigurinë në rrugë;
- Të përcaktoj faktorët dhe kontribuesit që ndikojnë në zvogëlimin e sigurisë dhe në shkaktimin e aksidenteve në rrugë;

- Të ofrojë ekspertizën e duhur lidhur me nivelin e sigurisë në komunikacionin rrugorë në vend duke ofruar edhe rekomandimet përkatëse me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të sigurisë së lëvizjes në rrugë;
- Të ofrojë ekspertizën rreth standardeve të aplikuara (nderkombëtare) për rruget dhe trafikun rrugor si dhe aspektin e praktikave të mira për rritjen e sigurisë rrugore.
- Të veprojë në përputhje me rregullat dhe kodin e etikës që aplikohet në ZKA;
- Të jetë i gatshëm ti përgjigjet kërkesave të tjera që mund të dalin nga gjatë punës audituese (në teren/ekzaminimet) dhe që konsideron të nevojshme për nevoja të auditimit siç janë pjesëmarrja në takime me ekipin, me palët e audituara si dhe komunikimi i vazhdueshëm me ekipin e auditimit.

Përgatitja e raportit

Raporti i Ekspertizës do të fokusohet në prezantimin e të dhënave dhe analizave mbështetëse në një vëllim të veçantë, nëse është e nevojshme. Duhet të përfshijë një përmbledhje ekzekutive që diskuton shkurtimisht gjetjet e rëndësishme dhe veprimet e rekomanduara. Struktura e sugjeruar e raportit është e përshkruar më poshtë:

- Përmbledhja e përgjithshme;
- Qasja dhe metodologjia e përdorur;
- Politikat, ligjet, rregulloret, standardet;
- Analizat e kryera;
- Ndikimet potenciale në sigurinë rrugore;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

Kërkesat e punës

Eksperti i sigurisë rrugore duhet të ketë edukimin relevant në shkenca teknike në fushën e Inxhinierisë së Trafikut dhe Transportit.

Eksperti duhet të ketë 5 vite përvojë pune në fushën e sigurisë rrugore.

Përparësi kanë kandidatët që kanë të përfunduar studimet e larta, kandidatët që posedojnë hulumtime, publikime dhe ekspertiza të lidhura me sigurinë rrugore.

Kandidatët e interesuar duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

- Letër Motivuese;
- Biografi (CV);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë për studimet universitare;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse;
- Përparësi kanë përfundimi i studimeve të doktoratës;
- Kopjet e trajnimeve relevante të kryera (nëse ka); dhe
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.